

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga Flutter Entertainment Holdings Ajrlend Limited (Flutter Entertainment Holdings Ireland Limited), me seli të regjistruar në Belfild Ofis Park, Biiç Hill Roud, Klonskig, Dublin 4, Dublin D04 V972, Irlandë, nëpërmjet avokatës Lupka Noveska Andonova nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 24.10.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Flutter Entertainment Holdings Ajrlend Limited (Flutter Entertainment Holdings Ireland Limited), me seli të regjistruar në Belfild Ofis Park, Biiç Hill Roud, Klonskig, Dublin 4, Dublin D04 V972, Irlandë, fiton kontroll të pavarur mbi Maks Bet d.o.o.Novi Sad (Max Bet doo. Novi Sad), me seli të regjistruar në Kisaçka 82, Novi Sad, Serbi, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 28.09.2023, e plotësuar më 29.09.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar një njoftim i përqendrimit nga Flutter Entertainment Holdings Ajrlend Limited (Flutter Entertainment Holdings Ireland Limited), me seli të regjistruar në Belfild Ofis Park, Biiç Hill Roud, Klonskig, Dublin 4, Dublin D04 V972, Irlandë,, me të cilin Flutter Entertainment Holdings Ajrlend Limited fiton kontroll të pavarur mbi Maks Bet d.o.o.Novi Sad (Max Bet doo. Novi Sad), me seli të regjistruar në Kisaçka 82, Novi Sad, Serbi, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Flutter Entertainment Holdings Ajrlend Limited i përket grupit të shoqërive Flutter („Grupi Flutter“).

Grupi Flutter është një grup shoqërisht që janë aktive në nivel global në sektorin e basteve sportive dhe organizimit të lojërave (aktivitetet e lojërave). Grupi Flutter ka katër departamente:

- Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda, të fokusuar në markat e basteve sportive dhe lojërave në Mbretërinë e Bashkuar („MB“) dhe Irlandë, e cila operon kryesisht online (por edhe përmes bastorëve në MB dhe Irlandë);
- Australi, e cila përbëhet nga marka online e basteve sportive Sportsbet (Sportsbet), një korporatë bastesh në Australi;
- SHBA, e cila përbëhet nga FanDuel, TVG dhe PokerStars. Departamenti zotëron një ofertë të ndryshme produktesh të buletineve online dhe të shitjes me pakicë për baste sportive, lojëra online, poker, baste të avancuara të depozitave në garat me kuaj dhe transmetim televiziv;
- Internacional, e cila menaxhon markat PokerStars, PokerStars Kasino, PokerStars Sports, Betfair International, Sisal, Adjarabet dhe Jungle Games; ku Flutter Group operon me licenca në afërsisht 22 vende të botës.

Grupi Flutter ka një shoqëri të regjistruar në Maqedoninë e Veriut - Shoqëria e programimit kompjuterik SINGULAR GROUP SHPKNJP Shkup, me seli në Franz Mesesnel nr. 2 Shkup - Karposh, Maqedonia e Veriut dhe aktivitet prioritar i regjistruar – programim kompjuterik.

Maks Bet d.o.o. Novi Sad është aktiv si organizator i lojërave të fatit. Maks Bet d.o.o. Novi Sad është aktiv vetëm në baste me pakicë në Maqedoninë e Veriut. Maks Bet d.o.o. Novi Sadi ka një shoqëri të regjistruar në Maqedoninë e Veriut - Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit MAKS BET SHPKNJP Shkup me seli në Skupi nr. 1 G-1 /d.p.1 Shkup-Karposh dhe aktiviteti prioritar i regjistruar – lojërat e fatit dhe bastet.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски